

Nue OROSHI, I. E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike

Në një atmosferë të rrallë e solemne, në Hamburg të Gjermanisë, pas gjashtëdhjetë vjet harrese e përbuzjeje të nacionalistëve të Shqipërisë etnike, u mbajt një akademi përkujtimore e të Djathtës shqiptare në shenjë nderimi dhe përkujtimi të 100- vjetorit të lindjes së inxh. Xhafer Devës, udhëheqësit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, dhe 58-vjetorit të rënies heroike të komandantit legjendar dhe udhëheqësit të luftës për Shqipërinë Etnike, Kapidan dr. Mark Gjon Markut. Në këtë solemnitet morën pjesë shqiptarë nga të gjitha viset e Shqipërisë etnike. Nga Shqipëria ishte prof. dr. Romeo Gurakuqi, nga Çamëria Muharrem Canaj, nga Kosova kishte më shumë përfaqësues dhe ligjërues, si akademik Mark Krasniqi, prof. dr. Muhamet Shatri, prof. dr. Jahja Drançolli, deputeti i parlamentit të Kosovës Fadil Geci, kryetari i Partisë Liberale të Kosovës Gjergj Dedaj, mandej Jetish Kadishani e Besim Morina. Malësinë e përfaqësonin maestro i artit shqiptar Gjelosh Gjokaj dhe publicisti Fran Camaj; nga Maqedonia ishte dr. Riza Sadiku, nga Amerika veprimtari i palodhur i çështjes kombëtare dhe njëherësh sekretar i Lidhjes së Prizrenit në mërgim, Tom Mrijaj. Diaspora e Evropës përfaqësohej nga Emin Fazlia, Niman Mulliqi, Luz Thaçi, Hazir Krasniqi, si dhe luftëtari dhe krahu i djathtë i Adem Jasharit, Gani Geci; nga Suedia ishte piktori Rustem Bujupi bashkë me veprimtarët Rexhep Jashari e Ibrahim Meta, ndërsa nga Austria Prek Brahim.

Në emër të Këshillit organizativ të pranishmit i përshëndeti historiani Nue Oroshi, i cili më pas ftoi akademik Mark Krasniqin që ta hapë këtë akademi përkujtimore. Në vazhdim u dha një program i shkurtër artistik me ç'rast recituan poezi nxënësit shqiptarë që jetojnë në Hamburg, u këndua kënga e bashkimit kombëtar "*Thërret Prizreni mori Shkodër*", ndërsa poeti Ejup Krasniqi deklamoi vargje të poemës së Ernest Koliqit *Kënga e Kapidan Markut*. Pas hapjes së ekspozitës së piktorëve Gjelosh Gjokaj, Rustem Bujupi dhe Mentor Ejupi u kalua në pjesën shkencore. Anëtarë të Këshillit drejtues u zgjodhën akademik Mark Krasniqi, Emin Fazlia, Muharrem Canaj dhe Muhamet Shatri.

Ligjëruesi i parë, prof. dr. Muhamet Shatri, foli në temën *Përpjeket e Lidhjes së Dytë të Prizrenit për jetësimin e aspiratave jetike të kombit shqiptar*. Në fjalën e tij, ndër të tjera, ai tha se "Lidhja e Dytë e Prizrenit ishte organizata më e rëndësishme politiko-ushtarake në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare, e krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo u organizua simbas shembullit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe u angazhua deri në fund për çlirimin dhe bashkimin e trojeve etnike shqiptare në një shtet të përbashkët. Interesim zgjoi edhe kumtesa e prof. dr. Jahja Drançollit me titull *Dimensionin historik i Lidhjes së Dytë të Prizrenit*, si edhe Kujtimet e akademik Mark Krasniqit për atdhetarin Gjon Serreqi. Më pas u lexua kumtesa e publicistit Idriz Lamaj me titull "*Tue kujtue Xhafer Devën*", ku u paraqitën disa

karakteristika që e cilësonin Xhafer Devën si atdhetar të mirëfilltë, burrshtetas të fortë, të drejtë e të dashur, të urrejtur prej pjellës së kuqe, por stoik, të rreptë e të vendosur, modern, patriot, bujar e kursimtar. Lamaj foli sidomos për letërkëmbimet e Xhafer Devës me intelektualë shqiptarë dhe amerikanë. Edhe kumtesa e Nue Oroshit “*Kapidan dr. Mark Gjon Marku udhëheqës i luftës për Shqipërinë Etnike*” ishte e një rëndësie të veçantë. Historiani i ri Oroshi paraqet gjenealogjinë e kësaj dere bujare shqiptare që për pesëqind vjet e mbajti krenarinë kombëtare, duke u përqendruar në veprën dhe sakrificën e Kapidan dr. Mark Gjon Markut. Me interes ishte edhe kumtesa e Emin Fazlisë për profesor Ymer Berishën, të cilin referuesi e cilësoi si farkëtar të denjë të bashkimit kombëtar dhe të rivendosjes së Shqipërisë Etnike. Të pranishmit në sallë u entuziazmuan kur përfqësuesi i Çamërisë Muharrem Canaj, i veshur në rroba kombetare çame, referoi mbi qëndrësën dhe tragjedinë çame duke filluar me vargjet “Moj Shqiponja dykrenare, pse m’ke hipur në atë minare, kërkto rrugën për në Janinë, për në Prevezë dhe Prishtinë, se atje e kam shtëpinë”. Ai më pas foli për luftërat e Çamërisë. I një rëndësie të veçantë ishte edhe referimi i prof. dr. Romeo Gurakuqit për profesor Ernest Koliqin dhe kontributin e tij atdhetar e politik. Ndërkaq, sekretari i Lidhjes së Prizrenit në mërgim Tom Mrijaj, i ardhur nga Amerika, ligjëroi për heroinën Marie Shllaku. Fjalët e saja të fundit, tha referuesi, ishin vërtet lapidare: “Gjaku im i pastër, Kosovë, t’u bëftë dritë”.

Kjo akademi ishte paraparë të zgjaste dy ditë, por për shkak se shumica e të pranishmëve kishin marrë rrugë të gjatë dhe duhej të ktheheshin, u vendos që seanca e ditës së dytë të mbahej në mbrëmjen e ditës së parë kur kumtesat e tyre i lexuan Niman Mulliqi, i cili foli për aktivitetin e Mid-hat Frasherit, Fadil Geci i bëri një elaborim të shkëlqyeshëm Luftës së Drenices me theks të veçantë luftërave të Shaban Polluzhës, Mehmet Gradicës, si dhe të bajraktarit të Llaushës. Në vazhdim ligjëruan Gjergj Dedaj për Ndue Përlleshin, Fran Camaj për Pre Calin, dr. Riza Sadiku për Xhemë Gostivarin, Jetish Kadishani për Ukë Sadik Ramë Gjurgjevikun, Besim Morina për Ajet Gergurin, Luz Thaçi për Gjelosh Lulin.

Në këtë akademi për shkaqe teknike nuk kishin mundur të mermin pjesë edhe disa ligjërues, por që i kishin dërguar kumtesat e tyre, si mr. Llukman Halili, Petrit Palushi, Klajd Kapinova, Sefedin Krasniqi, Mehmet Gjoshi. Në fund u bë edhe promovimi i librit të Gani Gecit “Lufta pa maska”, atij të Tom Mrijajt “Marie Shllaku, bij e Shkodrës Martire e Kosovës”, libri i Maxhun Smajlit “Lufta dhe dilemat shqiptare” dhe libri i Idriz Lamajt “Xhafer Deva në dritën e letrave të tija dhe zbulesa tjera të Mërgatës Shqiptare”. Në fund Këshilli organizativ përshëndeti të gjithë ata që në mënyra të ndryshme kontribuan që kjo akademi, e para e këtij lloji për të Djathtën Shqiptare, të arrijë suksesin e duhur. Me një fjalë rasti u paraqit edhe luftëtari i orëve të para të UCK-së dhe bashkëluftëtari i Adem Jasharit, Gani Geci, i cili i bëri një elaborim Luftës së fundit në Kosovë, duke theksuar se ajo është vazhdimësi e luftës së Shaban Polluzhës e Mehmet Gradicës, e jo vazhdimësi e luftës së pansllavistëve komunistë, tradhtarëve Ali Shukriu, Sinan Hasani etj.